

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7061
E shtunë, 2 dhjetor 2023
Çmimi 0.50 €

Faktorët që çojnë në vrasje: Nga gjendja socio-ekonomike deri tek armët pa leje



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

BE-ja IA DËRGON OPOZITËS DRAFT-STATUTIN E ASOCIACIONIT



Partitë opozitare në Kosovë kanë pranuar draft-statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe nga Bashkimi Evropian, të cilin Kosova e ka pranuar javë më parë. Tashmë

partitë opozitare janë duke e shqyrtuar këtë dokument. Ndërkaq në dokumentin që është publikuar të premtën nga mediet, thuhet se Asociacioni, i themeluar nga ky statut,

siguron një kornizë vetëmenaxhuese për komunitetin serb brenda nivelit ekzistues komunal të vetëqeverisjes lokale dhe nuk do të ketë kompetenca ekzekutive

OPINION

PËR CILËT KUFIJ TË PRISHUR PO FLET MINISTRI LLAVROV?

F. 7

Milazim KRASNIQI



AKTUALE



IZRAELI RINIS SULMET NË GAZË PAS PËRFUNDIMIT TË ARMËPUSHIMIT

F. 2

TREMBËDHJETË RASTE TË REJA ME HIV/AIDS NË KOSOVË

F. 6

EKONOMI



KURTI VIZITON GJILANIN, TREGON PËR PROJEKTET QË JANË NË PLANIFIKIM PËR VITIN E ARDHSHËM

F. 8

BORDI I AKP-SË APROVOI PRANIM-DORËZIMIN E EKONOMIVE PYJORE TEK AGJENCIA PYJORE E KOSOVËS

F. 8

SPORT



KOSOVA PROMOVHET NË LIGËN B TË LIGËS SË KOMBEVE

F. 10

DEKLARATA E LIBURN ALIUT "KOSOVA SHITET I PAVARUR ËSHTË PROJEKT I PËRKOHSHËM" NXIT REAGIME TË SHUMTA



DASH-I KRITIKON KOSOVËN PËR DËNIME TË ULËTA PËR AKUZAT E LIDHURA ME TERRORIZËM

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Izraeli rinis sulmet në Gazë pas përfundimit të armëpushimit



TEL AVIV, 1 DHJETOR - Avionët luftarakë izraelitë kanë goditur caqe të Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - në Rripin e Gazës më 1 dhjetor, pak pasi përfundoi armëpushimi njëjavor, tha ushtria.

Sulmet ajrore kanë goditur jugun e Gazës, përfshirë komunitetin Abasan në lindje të qytetit Han Junis, tha Ministria e Brendshme në territorin e kontrolluar nga Hamasi. Një sulm tjetër ka goditur veriperëndimin e Qytetit të Gazës.

Shpërthime të fuqishme janë dëgjuar në Rripin e Gazës teksa qielli i këtij territori palestinez është mbuluar nga tymi i zi.

Në Izrael sirenat për sulme janë dëgjuar në zonat afër Gazës që sugjerojnë se Hamasi, po ashtu, ka rinisur sulmet e tij.

Ushtria izraelite njoftoi për rinisjen e sulmeve vetëm 30 minuta pasi përfundoi armëpushimi në orën 07:00,

sipas kohës lokale.

Banorët thanë se Izraeli ka lëshuar pamflete në pjesë të jugut të Gazës, duke u bërë thirrje njerëzve të largohen nga shtëpitë në lindje të qytetit Han Junis. Në pamflete shkruhej se Han Junisi tani është "zonë e rrezikshme betejë".

Pamfletet, po ashtu, sugjerojnë se Izraeli është përgatitur për ta zgjeruar ofensivën e tij, që deri më tani ishte përqendruar në pjesën veriore të Rripit të Gazës. Më herët gjatë së premtes Izraeli akuzoi Hamasi se kishte shkelur marrëveshjen e armëpushimit, përfshirë hedhjen e raketave nga Gaza drejt Izraelit.

Ndërprerja e luftimeve nisi më 24 nëntor, dhe fillimisht armëpushimi ishte paraparë të zgjaste katër ditë, por ai u vazhduar edhe për disa ditë të tjera me ndërmjetësimin e Katarit dhe Egjiptit.

Gjatë armëpushimit njëjavor Hamasi dhe militantë të tjerë në Gazë liruan mbi 100 pengje,

shumica e të cilëve izraelitë, në këmbim të lirisimit të 240 palestinezëve që gjendeshin në burgjet në Izrael.

Pothuajse të gjithë të liruarit ishin gra dhe fëmijë, por fakti që mbetën vetëm pak pengje të tilla në Gazë ndërlikoi arritjen e një marrëveshjeje për zgjatjen e armëpushimit.

Hamasi, që kontrollon Gazën që 16 vjet, ka pritur të përfitojë më shumë nga lirimi i pengjeve të mbetura, veçmas për ushtarët izraelitë. Afër 140 pengje vazhdojnë të jenë në Gazë, ndërkaq mbi 100 u liruan në bazë të marrëveshjes së armëpushimit. Katarit dhe Egjiptit, që kanë qenë ndërmjetësuesit kyçë, synuan që ta zgjasnin armëpushimin edhe për dy ditë të tjera.

Izraeli po përballtet me presion në rritje nga aleatja e tij kryesore, ShBA-ja, për të bërë më shumë në mbrojtjen e civilëve palestinezë pas rinisjes së sulmeve ndaj Hamasit.

Një ditë më herët sekretari

amerikan i Shtetit, Antony Blinken, u takua me kryeministrin izraelit Benjamin Netanyahu dhe zyrtarë të tjerë të lartë gjatë vizitës së tij të tretë në rajon që nga nisja e luftës dy muaj më parë.

Përdërisa tha se kishte shpresë se armëpushimi do të mund të zgjatej, më 30 nëntor Blinkeni, po ashtu, deklaroi se nëse Izraeli rinis luftën dhe kryen sulme në jug të Gazës në ndjekje të Hamasit, duhet ta bëjë këtë "në përputhje me ligjin humanitar ndërkombëtar" dhe "duhet të ketë një plan të qartë" për t'i mbrojtur civilët.

Izraeli kishte thënë se do ta mbante armëpushimin deri kur Hamasi të ndalonte së liruar pengje dhe ishte zotuar se do ta riniste fushatën për ta shtypur Hamasin, edhe pse administrata e presidentit amerikan, Joe Biden, ka thënë se nëse Izraeli rinis sulmet, duhet t'i kryejë ato me precizitet të lartë.

Shumica e popullsisë 2.3 milionëshe të Gazës tani gjendet

në jug dhe nuk ka kah të ikë, duke ngritur pyetje se si ofensiva e Izraelit mund të shmangë humbje të mëdha në mesin e civilëve.

Në përgjithësi, 83 izraelitë, përfshirë persona me shtetësi të dyfishtë, u liruan gjatë armëpushimit. Edhe 24 pengje të tjerë - 23 tajlandezë dhe një filipinas - u liruan, përfshirë edhe disa burra.

Është e paqartë se në mesin e pengjeve të mbetura në Gazë sa prej tyre janë gra e sa ushtarë.

Izraeli ka thënë se afër 125 burra janë ende duke u mbajtur peng. Para armëpushimit, Hamasi kishte liruar katër pengje dhe Izraeli kishte shpëtuar një. Ndërkaq, dy pengje u gjetën të vdekur në Gazë.

Sa iu përket 240 palestinezëve të liruar, shumica e tyre ishin adoleshentë që kishin hedhur gurë drejt forcave izraelite gjatë përlëshjeve me ta. Po ashtu, janë liruar edhe disa gra që ishin dënuar për tentim-sulme ndaj ushtarëve.

Hamasi nisi luftën me sulmet vdekjeprurëse të 7 tetorit në jug të Gazës, gjatë të cilave radikalët palestinezë vranë afër 1 200 persona dhe morën peng 240 të tjerë.

Që atëherë nga sulmet izraelite në Gazë janë vrarë mbi 13 300 palestinezë, pothuajse dy e treta e viktimave janë gra dhe fëmijë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në Gazën e kontrolluar nga Hamasi. Mbi tri e katërta e popullsisë së këtij territori janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre për shkak të bombardimeve dhe sulmeve tokësore të Izraelit që krijuan një krizë humanitare.

Numri i viktimave në Gazë pritet të jetë më i lartë, pasi autoritetet që nga 11 nëntori nuk kanë përditësuar vazhdimisht të dhënat. Ndërkaq, Izraeli ka thënë se gjatë sulmeve tokësore i janë vrarë 77 ushtarë, ndërsa pretendon se ka vrarë mijëra luftëtarë të Hamasit, por për këtë pretendim nuk ka ofruar dëshmi.

Irani, sipas ShBA-së, sponsori kryesor shtetëror i terrorizmit,

TEHRAN, 1 DHJETOR - Irani mbeti sponsori kryesor shtetëror i terrorizmit global vitin e kaluar, duke u përfshirë në mbështetjen e rekrutimit të terroristëve, financimit dhe komplotëve nëpër Afrikë, Azi, Evropë dhe në të dyja Amerikat, tha Departamenti Amerikan i Shtetit në raportin e tij për terrorizmin 2022, i cili u publikua më 1 dhjetor.

Në Lindjen e Mesme, Irani e vazhdoi mbështetjen për

Hezbollahun, një grup i shpallur organizatë terroriste nga Uashingtoni më 1997, thuhet në raport, i cili shton se Teherani i dha armë Hamasit dhe grupeve të tjera palestineze të cilësuar si terroriste nga ShBA-ja. "Këto grupe ishin përgjegjëse për sulme të shumta vdekjeprurëse që kishin zanafillën në Rripin e Gazës dhe Bregun Perëndimor", thuhet në raport.

Teherani i ka përkrahur edhe grupet ekstremiste në Bahrein, Irak

dhe Siri, përmes Forcës Quds të Gardës Revolucionare të Iranit (IRGC-QF), për të ofruar mbështetje për organizatat terroriste me qëllim që të krijojnë trazira në rajon, sipas raportit.

Irani vazhdimisht ka nxitur dhe komplotuar sulme ndaj Shteteve të Bashkuara, përfshirë kundër ish-zyrtarëve amerikanë, si hakmarrje për vdekjen e komandantit të Forcës Quds, Qasem Soleimani në janar 2020.



Faktorët që çojnë në vrasje: Nga gjendja socio-ekonomike deri tek armët pa leje

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Vrasjet në Kosovë janë duke alarmuar shoqërinë dhe duke shtuar panikun, thonë njohës të fushës së sigurisë dhe të sociologjisë. Paniku, sipas tyre, shtohet edhe më kur vrasjet ndodhin brenda një periudhe të shkurtër kohore. Tri vrasje u raportuan në dy ditë të kësaj jave nga Policia e Kosovës. Të tria ndodhën në Prishtinë.

Të mërkurën një grua u qëllua për vdekje me armë zjarri gjatë një grabitjeje të dyshuar. Po atë ditë një burrë humbi jetën nga shkaktimi i plagëve me thikë.

Të enjten, një i dyshuar për një grabitje që ndodhi më 22 nëntor në një argjendari në Suharekë, u vra gjatë një këmbimi të zjarrit me policinë. Për të tria rastet policia tha se është duke hetuar dhe se ka disa të arrestuar.

Sipas të dhënave të saj për periudhën janar-tetor të këtij viti, numri i vrasjeve të evidentuara në Kosovë ka qenë 26. Në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ishte 21. Shumica e këtyre vrasjeve thuhet se janë kryer me armë zjarri.

Çka çon deri tek akti i dhunshëm?

Avni Islami, profesor i Shkencave të Sigurisë në Kosovë, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se shumica e këtyre vrasjeve kanë një emërues të përbashkët: faktorin ekonomik-social. "Nuk mund ta fshehim se shkalla e papunësisë është e madhe, shkollimi joadekuat, ashtu sikurse edhe niveli i mirëqenies sociale në çdo familje", thotë ai.

Me këtë mendim pajtohet edhe sociologja Erisë Hajrizi. Sipas saj, kjo situatë ndodh si pasojë e panikut që kanë njerëzit nga ndjenja e pasigurisë së përgjithshme. Ajo thotë se kjo ndjenjë buron edhe nga mosbesimi ndaj institucioneve dhe shërbimeve që ato ofrojnë. Kontribut, shton Hajrizi, kanë edhe rrjetet sociale dhe media të caktuara me, siç shprehet, "shkrime joprofesionale". "Raportohet në një mënyrë krejtësisht polarizuese, 'e tmerrshme', 'shikojeni se si është kryer një krim në Kosovë', ose 'e vrau këtë, ose atë'... Nuk ka gjuhë profesionale për t'iu qasur masës, për të mos krijuar panik dhe ndjenjë të frikës. Ndonjëherë, vetë ideja që ne mendojmë se ekziston një krim, e sjell një krim", thotë Hajrizi për "Radion Evropa e Lirë". Sipas saj, edhe migrimi i brendshëm ka vënë përballë mentalitete të ndryshme të njerëzve, mosmarrëveshjet e të cilëve shndërrohen në "qërim hesapësh".

"I shohim vazhdimisht këto polarizime, qofshin ato politike apo ekonomike. I sheh disa njerëz të cilët jetojnë një jetë të lumtur, ose në një rrafsh krejt tjetër social



dhe, po ashtu, sheh një pjesë tjetër që jeton në një rrafsh krejt tjetër social dhe ekonomik. Sigurisht që polarizimet ose ekstremet te njerëzit ose te popullatat [e caktuara] sjellin ndeshje të njëra-tjetrës dhe pastaj vjen deri te një moskuptim shoqëror", thotë Hajrizi.

Kosova nuk ka të dhëna të përditësuara për varfërinë në vend. Të fundit, të përpiluara nga Agjencia e Statistikave e Kosovës dhe Banka Botërore, janë të vitit 2017 dhe, sipas tyre, 18 për qind e popullsisë së Kosovës jeton në varfëri, përkatësisht me rreth 2 euro në ditë, kurse 5.1 për qind në varfëri të skajshme apo me më pak se 1.5 euro në ditë. Shkalla e papunësisë është gati 12 për qind.

Këtë vit ishte në rënie, por vitin e kaluar Kosova e mbylli me shkallë të inflacionit rreth 12%, nga 3.4% sa ishte në vitin 2021.

Paga mesatare në vend është rreth 520 euro, ndërsa minimalja sillet nga 130 deri në 170 euro.

Disa kategori të shoqërisë përfitojnë nga skemat sociale që ndajnë institucionet e vendit.

Duke u bazuar në të dhënat zyrtare, Islami thotë se shkalla e vrasjeve në Kosovë po shënon ngritje. Sipas tij, një numër i madh i armëve vazhdon të mbetet në mënyrë të paligjshme në duart e qytetarëve. "Ndjenja nga vetë arma dhe krisma e armës është një lloj pasigurie. Mirëpo, kjo lloj ndjenje... nëse vazhdon kështu, secili nga ne do të mendojë se si të dalë nga shtëpia dhe sa është i sigurt", shprehet Islami.

Politikë "e butë" e ndëshkimit për armëmbajtje pa leje

Policia e Kosovës nuk iu përgjigj pyetjes së "Radios Evropa e Lirë" për numrin e armëve pa leje të konfiskuara deri në muajin nëntor të këtij viti. Por, në periudhën janar-korrik, sipas të

dhënave të saj, janë konfiskuar 636 armë zjarri. Vitin e kaluar numri i armëve të konfiskuara ka qenë 1 473. Po sipas këtyre të dhënave, policia, çdo vit konfiskohen 1 200 deri në 1 500 armë ilegale.

Një hulumtim i vitit 2015 i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës ka treguar se 250 mijë armë ilegale kanë qenë në pronësi të qytetarëve.

Shpat Balaj, hulumtues në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se armëmbajtja pa leje është bërë dukuri problematike. "Përgjithësisht ka shumë armë pa leje në duart e qytetarëve dhe, rrjedhimisht, shkalla e krimeve të kryera me armë, në vitet e fundit, është duke u rritur dhe është duke u bërë edhe më problematike", thotë Balaj.

Kodi Penal i Kosovës e sanksionon armëmbajtjen pa leje me gjobë prej 7 500 eurosh ose dënim me burg deri në 5 vjet. Aty parashihet edhe dënim dy deri në 10 vjet burg për posedim ilegal të katër ose më shumë armëve ose më shumë se 400 fishekëve. Për përdorimin e paligjshëm të armës "në mënyrë kërcënuese ose frikësuese", është përcaktuar dënimi me gjobë deri në 10 000 euro dhe me burgim deri në 10 vjet.

Balaj thekson se sanksionet ligjore për armëmbajtje pa leje nuk janë të buta, por i tillë është zbatimi i tyre nga gjykatat. Sipas tij, kjo ka bërë që fenomeni i armëmbajtjes pa leje të marrë hov. "Shumica e dënimeve për armëmbajtje pa leje kalojnë me gjobë. Gjobat, në parim, nuk janë aq të larta, janë të përballueshme", thotë Balaj.

"Radio Evropa e Lirë" iu drejtua Këshillit Gjyqësor të Kosovës me pyetjet se sa është numri i përgjithshëm i aktgjyqimeve në të gjitha gjykatat në Kosovë për veprën penale "mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" gjatë

vitit 2023 si dhe sa raste janë ndëshkuar me gjobë, me kusht dhe me burg efektiv, por deri në publikimin e këtij artikulli ky institucion nuk ktheu përgjigje.

Gjobat "sikur për kundërvajtje"

Të dhënat lidhur me numrin e përgjithshëm të aktgjyqimeve për armëmbajtje pa leje për tre vjetët e fundit nuk ka arritur t'i sigurojë as Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), i cili mbikëqyr punën e institucioneve të drejtësisë në vend, thotë Eranda Zekaj, hulumtuese në këtë institut.

Por, nga një hulumtim i IKD-së vitin e kaluar, thotë ajo, ka rezultuar se gjykatat, gjatë viteve 2018 dhe 2019, kanë zbatuar politika të buta të ndëshkimit për kryerësit e veprës penale të armëmbajtjes pa leje.

Hulumtimi, sipas saj, ka treguar se gjykatat themelore gjatë vitit 2019 kanë shqiptuar 133 dënime me gjobë, 46 dënime me kusht dhe 19 dënime me burgim. Ndërkaq gjatë vitit 2018 janë shqiptuar 157 dënime me gjobë, 126 dënime me kusht dhe vetëm 13 dënime me burgim. "Në qoftë se e marrim këtë paralele - për shembull në vitin 2019 deri në vitin 2020 kanë qenë vetëm 19 dënime me burg - shohim se kjo dukuri është tejet negative dhe ndikon tepër shumë ndaj preventivës dhe luftimit të saj në përgjithësi", thotë Zekaj për "Radion Evropa e Lirë".

Zekaj shton se jo rrallë dënimet me gjobë për veprën penale të armëmbajtjes pa leje "janë të krahasueshme me dënimet për kundërvajtje". "Pra, dënimi me gjobë, si sanksion që zbatohet për veprën e armëmbajtjes pa leje në Kosovë, nuk e arrin qëllimin final të dënimit, që është parandalimi individual dhe i përgjithshëm, për forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Kjo, duke marrë parasysh numrin e madh

të armëve pa leje që sekuestrohen nga ana e policisë së Kosovës në baza ditore, duke marrë parasysh krimet serioze që ndodhin ditë-ditës. Andaj, është e domosdoshme që politika ndëshkimore të ashpërsohet ndaj kryerësve të tillë, në mënyrë që të parandalohet kjo dukuri", vlerëson Zekaj.

Gjykatat themelore në shtatë rajonet e Kosovës nuk i kanë bërë publike të gjitha aktgjyqimet për armëmbajtje pa leje. Në pak nga këto aktgjyqime që janë publikuar në vitin 2023 për rastet e armëmbajtjes pa leje, e në të cilat "Radio Evropa e Lirë" ka pasur qasje, kryerësit e veprës penale janë gjobitur me gjoja prej 200 eurosh deri në 2 000 euro.

Dënim me burgim deri një vit e katër muaj për armëmbajtje pa leje është shqiptuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, por i akuzuari ishte dënuar edhe me 10 vjet të tjerë për vrasje.

Për armëmbajtje pa leje një dënim me 180 ditë burgim është evidentuar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.

Për dy javë 15 raste të armëmbajtjes pa leje

Sipas raporteve 24-orëshe, të cilat i publikon rregullisht Policia e Kosovës, në dy javët e kaluara janë evidentuar së paku 15 raste, ku armët e zjarrit janë përdorur ose janë mbajtur pa autorizim nga persona të caktuar.

Më 20 nëntor persona të maskuar dhe të armatosur me armë të gjata kanë sulmuar me mjet shpërthyes bankomatit e bankës TEB në Gjilan.

Më 22 nëntor katër persona të maskuar dhe të armatosur kanë kryer grabitje në një argjendari në Suharekë. Dy pjesëtarë të Policisë së Kosovës u plagosën gjatë këmbimit të zjarrit me grabitësit.

Po atë ditë, në dy raste veç e veç, në Prishtinë dhe Prizren, nga persona të dyshuar janë hedhur mjete shpërthyes. Në rastin në Prishtinë janë raportuar dëme materiale, ndërkaq në rastin në Prizren, si pasojë e shpërthimit, kanë pësuar lëndime trupore dhjetë persona.

Më 26 nëntor është shënuar edhe një rast i hedhjes së një granate në Mitrovicë të Veriut, por nuk ka pasur viktima.

Një person në Graçanicë, më 18 nëntor, dhe një person tjetër në Prishtinë, më 20 nëntor, janë gjetur të vdekur dhe dyshohet se kanë bërë vetëvrasje me armë zjarri.

Në përleshjet fizike, në tri raste veç e veç, më 15 nëntor në Gjilan, më 20 nëntor në fshatin Uglar të kësaj komune, si dhe më 21 nëntor në fshatin Shkabaj të Prishtinës, janë përdorur armët e zjarrit, të cilat më pas janë konfiskuar nga policia.



DASH-i kritikon Kosovën për dënime të ulëta për akuzat e lidhura me terrorizëm

Departamenti Amerikan i Shtetit ka bërë me dije se në Kosovë gjatë vitit 2022 institucionet e drejtësisë vazhduan të shqiptojnë dënime të ulëta për akuzat e lidhura me terrorizmin. DASH-i vuri në pah se Kosova ka legjislacion për ta luftuar edhe financimin e terrorizimit, por tha se ka mungesë të një strategji për t'i adresuar kërcënimet e lidhura me terrorizmin

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH-i) tha se në Kosovë gjatë vitit 2022 institucionet e drejtësisë vazhduan të shqiptonin dënime të ulëta për akuzat e lidhura me terrorizmin, dhe tha se ka edhe lirime të parakohshme për këto akuza.

Në raportin për terrorizmin për shtetet, sa i përket Kosovës, u tha se më 2022 Prishtina vazhdoi t'i riadhesonte shtetasit e saj nga kampet dhe qendrat e ndalimit në Siri.

Aty u tha se operacioni i tretë i riadhesimit në maj u krye në bashkëpunim me Shqipërinë dhe u mbështet nga Shtetet e Bashkuara. "Deri më tani Kosova ka riadhesuar mbi 120 shtetas. Vlerësohet se 80 shtetas të tjerë vazhdojnë të jenë në kampet e të zhvendosurve apo në qendrat e ndalimit, ose në fushëbeteja në Siri. Dënimet e ulëta për akuzat e

lidhura me terrorizmin kanë vazhduar", u tha në raportin e DASH-it. Sipas ShBA-së, qytetarët e Kosovës brenda dhe jashtë vendit "janë caqe potenciale për rekrutim nga organizata e dhunshme ekstremiste, me orientim etno-nacionalist apo fetar". "Gjatë vitit 2022 Kosova ndoqi penalisht një grua të riadhesuar me ndihmën e ShBA-së. Edhe pse kjo grua u dënua me dy vjet burgim për shkak të bashkimit në grupin Shteti Islamik, gjykatat e Kosovës kanë dënua të riadhesuarit me tre deri në katër vjet e gjysmën burgim për organizim dhe pjesëmarrje në aktivitetet terroriste të IS-it", u tha në raport. Po në raportin për Kosovën përmendet ngritja e aktakuzës ndaj Ylber Belës për organizim dhe pjesëmarrje në grup terrorist. Bela ishte riadhesuar në Kosovë në maj në përpjekjen e

përbashkët me ShBA-në.

Në raportin e DASH-it u përmend edhe rasti i aktakuzës ndaj katër personave të dyshuar për përgatitje të veprave terroriste kundër rendit kushtetues. Ata dyshohen se kishin tentuar të krijonin struktura organizative për të kryer sulme terroriste në Kosovë duke kontaktuar me një zyrtar të lartë të grupit Shteti Islamik.

DASH-i tha se në qershor Gjykata Themelore në Prishtinë liroi nga akuzat katër persona: dy dyshoheshin për përgatitje të sulmeve ndaj klubeve të natës, kishave dhe forcave të Kosovës, dhe dy për vepra të tjera penale. Ata u liruan në mungesë të provave.

Sipas ligjeve në Kosovë, për vepra terroriste dhe kundër rendit kushtetues parashihen dënime të ndryshme. Që nga viti 2015 në Kosovë, po ashtu, ndalohej pjesëmarrja në luftëra të huaja dhe, sipas ligjit, parashihen dënime deri në 15 vjet burgim.

DASH-i vuri në pah se Kosova ka legjislacion për ta luftuar edhe financimin e terrorizimit, por tha se ka mungesë të një strategjie për t'i adresuar kërcënimet e lidhura me terrorizmin. "Megjithatë, dënimet e shkurtra,

lirimet e parakohshme dhe me kusht, si dhe joroganizimi i mbikëqyrjes pas lirit, paraqesin kërcënime për sigurinë", u tha në raport.

Sa iu përket incidenteve terroriste më 2022, DASH-i përmend edhe arrestimin e ish-policit serb të Kosovës, Dejan Pantiq, në dhjetor të vitit 2022, nën akuza për terrorizëm, pas sulmit që përfshiu mjete shpërthyes ndaj zyrave lokale të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe ndaj stafit të këtij komisioni në Mitrovicë të Veriut. Arrestimi i tij kishte nxitur banorët lokalë të vendosnin barrikada në veri të Kosovës, duke bllokuar për disa javë rrugët që çonin drejt pikëkalimeve kufitare të Jarinjës dhe Bërnjakut, që lidhin Kosovën dhe Serbinë.

Barrikadat u hoqën pasi Pantiqit iu ndryshua masa e sigurisë nga paraburgim në arrest shtëpiak. Po ashtu, raporti përmend edhe dënimin që ua bëri Qeveria e Kosovës sulmeve të armatosura ndaj policisë në veri të Kosovës, që i cilësoi si akt terrorist. "Prokurorët kosovarë i klasifikuan këto incidente të lidhura me akuza terroriste dhe raste kundër rendit kushtetues". Sa i përket aspektit të sigurisë në

veriun e Kosovës, të banuar me shumicë serbe, raporti i DASH-it tha se "çështjet e sigurisë dhe paqëndrueshmëria politike në veri të Kosovës vazhdon ta kufizojë aftësinë e Qeverisë së Kosovës për ta shtrirë autoritetin e saj në atë rajon. Misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR dhe Misioni i BE-së për Sundim të Ligjit, EULEX, kanë bashkëpunuar me Policinë e Kosovës për të promovuar një mjedis të sigurt dhe forcimin e sundimit të ligjit".

DASH-i, po ashtu, përmend edhe vlerësimin e Ambasadës Amerikane në Prishtinë se që nga nisja e pushtimit rus të Ukrainës në shkurt të vitit të kaluar, në Kosovë ka pasur rritje të dezinformatave dhe se ato "janë gjithnjë e më shumë nxitëse të mendimit të dhunshëm ekstremist dhe polarizimi ndëretnik ka kontribuar në rritjen e tensioneve ndëretnike në veri të Kosovës".

Në një raport të publikuar në fund të nëntorit të vitit 2023, të hartuar nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN), u tha se Kosova është e ekspozuar ndaj dezinformatave dhe narrativeve që vijnë nga Rusia dhe Kina, të cilat synojnë të nxisin një luftë ndëretnike dhe ndërftare në Kosovë. (REL)

Deklarata e Liburn Aliut 'Kosova shtet i pavarur është projekt i përkohshëm' nxit reagime të shumta



Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, në një paraqitje televizive në "Televizionin 7", ka dhënë një deklaratë e cila ka ngjallur shumë reagime në vend nga përfaqësues të partive politike opozitare, të shoqërisë civile dhe gazetarë. Sipas Aliut, Kosova shtet i pavarur është projekt i përkohshëm, duke iu referuar aspiratës për bashkim me Shqipërinë. Kryeministri Albin Kurti kur është pyetur të premten nga gazetarët për deklaratën e ministrit të tij, ka pohuar se nuk e ka parë emisionin

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Deklarata e ministrit të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, se "Kosova është projekt i përkohshëm", ka nxitur reagime të shumta në vend.

Përfaqësues të partive politike opozitare, të shoqërisë civile dhe gazetarë nuk e kanë parë si deklaratë të mençur.

Ministri i Infrastrukturës, Liburn Aliu, në emisionin "Zanat" në T7, i cili është transmetuar të enjten në mbrëmje, ka theksuar se Kosova është një projekt i përkohshëm, duke iu referuar aspiratës për bashkim me Shqipërinë. "Unë e shoh sot Kosovën më shumë si një projekt të përkohshëm. Cilat janë elementet që sot përpiqen për ta krijuar kombin kosovar? Kushtetuta e Republikës së Kosovës është e një vendi multietnik. Pra çfarë është

kosovari? A është kosovari shqiptar apo diçka tjetër. Nëse do të krijonim një komb kosovar që do të synonte një përzierje të etnive, është një tendencë e cila nuk e di sa do të ketë sukses dhe nuk është duke pasur sukses", ka thënë Aliu, duke shtuar se projekti Kosova shtet i pavarur është një projekt i përkohshëm. "Unë mendoj se projekti Kosova shtet i pavarur është një projekt i përkohshëm, i cili ka me marrë një rrugë. Rruga është normale, pra zhvillimi ekonomik, qarkullimi i vazhdueshëm brenda gjithë Ballkanit, do ta kthejë në vendin e vet situatën ku do të shuhet të gjitha shovinizmat e të gjithë do të ktheheshin në vendin e vet", ka thënë Aliu.

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, në reagimin e tij ndaj deklaratës së ministrit Aliu, ka theksuar se çfarë të duhen kundërshtarët e jashtëm kur i ke të brendshmit.

Ai ka thënë se Republika e Kosovës sot udhëhiqet nga popullistë mosbesues të saj. "Fati i projektit më të madh shqiptar, 'Kosova shtet i pavarur e sovran', është në duar të mohuesve të vet shtetësisë. Prandaj betimi mbi Republikë është farsë. Prandaj shkelja e Kushtetutës bëhet zakonshmëri. Sepse mosbesimi ndaj Kosovës është bindje. Këta kanë atdhe të dytë. Ne kemi vetëm Kosovën", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook".

Ai ka shtuar se LDK-ja si formacion i vetëm pavarësist beson në republikë. "Fëmijët tanë meritojnë të besojnë në Republikë! Në shtetin që prindërit e gjyshërit e tyre nuk e kishin por ua kanë lënë me plot sakrificë. Në shtetin që në vend të mbytjes së ëndrrave e dhënies së pasigurisë u jep shpresën se një ditë do të jenë të barabartë mes popujve e shteteve euroatlantik! Prandaj dhe zgjedhja juaj është fare e lehtë.

Sepse Kosova është e përhershme", ka thënë Abdixhiku.

Nënkryetarja e PDK-së, Vlora Çitaku, ka thënë se nuk mund ta duash Shqipërinë duke e urreyer Kosovën. "Qeveritë janë të përkohshme. Kosova është e përjetshme", ka shkruar Çitaku në "Facebook".

Ndërsa deputetja nga radhët e PDK-së, Eliza Hoxha, i është referuar deklaratës së Aliut, duke thënë se "kështu e shohin Kosovën njerëzit që i keni votuar 51 %".

Opinionisti Imer Mushkolaj e ka quajtur Aliun "politikan sharlatan" si dhe "dështak e demagog të gërditshëm". "Qe një politikan sharlatan, i cili nuk i beson shtetit të cilit do të duhej t'i shërbente. Nëse ky nuk i beson shtetit të vet, qysh me i besu qytetarët këtij dhe të tjerëve si ky, që kanë me e kry ndonjë punë t'hajrit, që e çojnë këtë vend përpara. Një dështak e demagog i gërditshëm", ka shkruar Mushkolaj në "Facebook".

Ndërsa gazetari Ilir Mirena, duke iu referuar deklaratës së Aliut, ka shkruar në "Facebook" se "ju jeni të përkohshëm, Kosova është e përjetshme...".

Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, edhe të premten ka vazhduar t'i qëndrojë mbrapa

deklaratës së dhënë një ditë më parë se shteti i pavarur i Kosovës është projekt i përkohshëm. Aliu në një prononcim për "Klankosova.tv" ka pohuar se për të Kosova është proces kalimtar drejt bashkimit me Shqipërinë. "E konfirmoj që për mua Kosova, në rrethanën në të cilën është, me Kushtetutë e këto gjëra, është projekt i përkohshëm. Është proces kalimtar drejt bashkimit me Shqipëri. Sqarimet më tej i bëjmë bashkë kur të kthehem në Kosovë", ka thënë Aliu.

Kryeministri Albin Kurti, kur është pyetur të premten nga gazetarët për deklaratën e ministrit të tij, ka pohuar se nuk e ka parë emisionin. "Nuk po më duket e përshtatshme që unë të bëj komente të emisioneve televizive të cilat nuk i kam parë", është shprehur Kurti.

Megjithatë, nga informacionet e marra nga zëdhënësi i Qeverisë së Kosovës, Përparim Kryeziu, Kurti ka deklaruar se ka kuptuar që emisioni në fjalë ka qenë i natyrës festive për nder të 28 Nëntorit. "Zëdhënësi im Përparim Kryeziu më tha që ai (Liburn Aliu) ka qenë një emision festiv në ditët e Festës së Flamurit dhe pavarësisë së 28 Nëntorit. Sot këtu në Gjilan jemi për punë, të cilat po bëhen për qytetarët, për të mirën e tyre, dhe besoj që ky është përqendrimi sot", ka thënë kryeministri Kurti.

BE-ja ia dërgon opozitës draft-statutin e Asociacionit

Partitë opozitare në Kosovë kanë pranuar draft-statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe nga Bashkimi Evropian, të cilin Kosova e ka pranuar javë më parë. Tashmë partitë opozitare janë duke e shqyrtuar këtë dokument. Ndërkaq në dokumentin që është publikuar të premten nga mediet, thuhet se Asociacioni, i themeluar nga ky statut, siguron një kornizë vetëmenaxhuese për komunitetin serb brenda nivelit ekzistues komunal të vetëqeverisjes lokale dhe nuk do të ketë kompetenca ekzekutive

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) kanë pranuar një ditë më parë nga Bashkimi Evropian një kopje të draft-statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Përfaqësuesit e këtyre partive kanë konfirmuar për "Telegrafin" pranimin e këtij draft-statuti. Ai i është dorëzuar edhe Qeverisë së Kosovës. "Partia Demokratike e Kosovës dhe e ka pranuar një kopje të draftit të Statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe nga Zyra e të Dërguarit Special të BE-së për dialogun Kosovë - Serbi", ka thënë zëdhënësi i PDK-së, Faton Abdullahu.

Edhe dy partitë e tjera, LDK-ja dhe AAK-ja, kanë konfirmuar se kanë pranuar draft-statutin për Asociacionin. Draft-statuti i Asociacionit i është paraqitur fillimisht kryeministrit Albin Kurti gjatë vizitës së pesëshes evropiane në Prishtinë gjatë muajit tetor, e ku ishte i pranishëm edhe i dërguari i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak.

Ndërkaq, pas vizitës në tetor, Lajçaku, po ashtu, ishte për vizitë në Kosovë më 7 nëntor, ku ka takuar përfaqësuesit e partive opozitare lidhur me draft-statusin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Pas këtij takimi, përfaqësuesit e partive opozitare patën dhënë deklarata kontradiktore në lidhje me atë se a kanë parë ose jo draft-statutin në takimin me Lajçakun. Gazeta "Express" ka siguruar draftin e plotë të Bashkimit Evropian.

Në hyrje të draftit theksohet se ai



është shkruar "në respekt të pavarësisë, autonomisë dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës".

Në draft thuhet se objektivi primar i këtij Statuti është të krijojë në Kosovë mundësi për komunitetin serb të Kosovës me përfitojë nga të drejtat specifike dhe kompetencat komunale tashmë të përfshira në Kushtetutë dhe ligje të tjera në fuqi, ndërsa pason paragrafi që siguron se Asociacioni nuk do të ketë kompetenca ekzekutive. "Asociacioni, i themeluar nga ky Statut, siguron një kornizë vetëmenaxhuese për komunitetin serb brenda nivelit ekzistues komunal të vetëqeverisjes lokale dhe nuk do të ketë kompetenca ekzekutive shtesë në krahasim me komunat anëtare të saj. Korniza përfshin mbështetjen e ofrimit të

koordinuar të shërbimeve në fusha specifike, me mundësinë e mbështetjes financiare nga Serbia dhe një kanal efektiv të komunikimit të drejtpërdrejtë për komunitetin serb të Kosovës me Qeverinë e Kosovës përmes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal".

Asociacioni ka objektivin e përgjithshëm t'i ndihmojë anëtarët e saj që të bashkëpunojnë në partneritet, brenda fushave të tyre të kompetencës, për të kryer funksione me interes të përbashkët. Asociacioni, sipas këtij drafti, do të angazhohet për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komunitetit serb të Kosovës në përputhje me Kapitullin III të Kushtetutës. Ky angazhim nuk do të zëvendësojë, përjashtojë,

zëvendësojë ose zvogëlojë të drejtat dhe interesat e subjekteve të tjera juridike që përfaqësojnë komunitetin serb të Kosovës për t'i ndjekur të njëjtat qëllime. "Në përmbushjen e objektivave të tij, Asociacioni nuk do të minojë apo anashkalojë autoritetin kushtetues dhe ligjor dhe kompetencat e anëtarëve të saj dhe në asnjë mënyrë të zëvendësojë ose minojnë marrëdhëniet kushtetuese dhe juridike ndërmjet autoriteteve qendrore dhe vendore në Kosovë". Ky Asociacion, sipas dokumentit të publikuar, do t'i menaxhojë institucionet e edukimit dhe shëndetësisë të cilat janë financiar drejtpërdrejt nga Serbia. "Themelimi dhe periodha fillestare dyvjeçare e veprimtarisë së Asociacionit (d.m.th. dy vitet e para pas fillimit të veprimtarisë së

Asociacionit) do të monitorohen nga Bashkimi Evropian. Pas dy viteve të para, Bashkimi Evropian do të vazhdojë ta monitorojë situatën nëse Asociacioni dhe Qeveria e Kosovës nuk vendosin ndryshe", thuhet në dokument.

Më tutje theksohet se: "Duke vepruar në emër të Asociacionit, katër kryetarët e komunave të Kosovës veriore - përderisa janë anëtarë të Asociacionit - do t'i ofrojnë Ministrisë së Punëve të Brendshme listën e kandidatëve për emërim si Komandant Rajonal i Policisë së Kosovës, siç specifikohet në nenin 9 të Marrëveshjes së Parë".

Në këtë draft-statut thuhet se donacionet e mallrave dhe pajisjeve nga Serbia do të përjashtohen nga çdo taksë apo detyrim në përputhje me ligjin në fuqi.

Trembëdhjetë raste të reja me HIV/AIDS në Kosovë

Prishtinë, 1 dhjetor - Dita ndërkombëtare e luftës kundër HIV/AIDS-it e gjen Kosovën me 13 raste të reja të personave të prekur me këtë virus gjatë vitit 2023.

Shefi i Repartit për Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme në Klinikën Infektive në Prishtinë, Murat Mehmeti, thotë për "Radio Evropa e Lirë" se këto raste janë paraqitur në institucionin që ai udhëheq. Aktualisht, sipas tij, aty janë duke u trajtuar dhe mbikëqyruar 65 raste.

Mehmeti bën thirrje për sa më shumë testime, duke theksuar rëndësinë e diagnostikimit të hershëm. "Zbulimi i hershëm i HIV-it nënkupton edhe fillimin e hershëm të trajtimit dhe



mundësinë më të vogël të paraqitjes së komplikimeve nga ky infeksion. Dihet se nëse ky infeksion avancohet dhe nuk zbulohet herët, atëherë vjen deri te dëmtimi në masë të imunitetit", thotë Mehmeti.

Në maj të këtij viti "Radio

Evropa e Lirë" raportoi për mungesë të terapisë në Klinikën Infektive për trajtimin e personave me HIV/AIDS, por infektologu Mehmeti siguron se ky nuk është më rast. "Tash për tash qëndrojmë mirë sa i përket terapisë", thotë ai.

Mehmeti, po ashtu, thekson se shumica e rasteve të reja të të infektuarve janë meshkuj të moshave të reja.

Vitin e kaluar në Kosovë u shënuan 17 raste të reja me HIV/AIDS, shifër që paraqiti dyfishim rastesh në krahasim me vitin 2021 kur ishin regjistruar tetë të tilla.

Testime për HIV/AIDS në Kosovë bëjnë edhe disa qendra jashtë Infektives, përfshirë Qendrën për Këshillim dhe Trajtim të Varësisë "Labirint".

"Radio Evropa e Lirë" kërkoi koment për këtë temë nga drejtori i kësaj qendre, Safet Blakaj, por nuk mori përgjigje. Virusi HIV e dëmtori sistemin imunitar të personit të prekur, duke e lënë atë të ekspozuar ndaj infeksioneve

të rënda. Ai mund të transmetohet nëpërmjet shkëmbimit të lëngjeve të ndryshme trupore nga individët e infektuar.

Rasti i parë me HIV/AIDS në Kosovë është paraqitur në vitin 1986 dhe që atëherë rreth 50 persona kanë humbur jetën.


Kosova radhitet në mesin e vendeve me shkallë më të ulët të HIV/AIDS-it.

Por, sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, HIV-i mbetet një problematikë e madhe sa i përket shëndetit publik.

Sipas të dhënave të OBSH-së, në fund të vitit 2022 kanë qenë 39 milionë njerëz të prekur me HIV/AIDS, shumica prej tyre në rajonin e Afrikës.

KOMENT URGJENT

Për cilët kufij të prishur po flet ministri Llavrov?



Milazim KRASNIQI

Sergej Llavrovi ka deklaruar në Shkup se gjoja në vitin 2008 me pavarësinë e Kosovës është shkelë rezoluta 1244 dhe parimi i OSBE-së për mosndryshimin e kufijve. Deklarata e tij është vetëm një mashtrim tipik pansllavist. Pse? Sepse kufijtë e shtetit federativ, RSFJ-së, i ka ndryshuar me dhunë Serbia, duke proklamuar Republikën Federative të Jugosllavisë, tutje Bashkësinë e Shteteve Serbia e Mali i Zi. Meqë RFJ ishte formacion shtetëror jolegal, në bazë të propozimit të Këshillit të

Sigurimit, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, më 19 shtator 1992 e pati refuzuar RFJ-në nga anëtarësia në atë organizatë, duke mohuar se mund të ishte trashëgimtare e RFSJ-së. Pra, RFJ (Serbia e Mali i Zi) nuk ka pasur kontinuitet me RFSJ. Pranimi në OKB i RFJ-së më 1 nëntor 2000, pas tetë vitesh nga mospranimi, i bërë me procedurë të shpejtuar dhe pa votim në OKB, ka qenë jo i rregullt, sepse RFJ nuk ka qenë trashëguese e RFSJ. Shpërbërja e asaj kuazifederate, të emërtuar në vijim si Bashkësia e Shteteve Serbia dhe Mali i Zi ndodhi në vitin 2006, pas referendumit në Malin e Zi. Pra shpërbërja e RFJ-së ndodhi dy vite para shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Kur u shpall Kosova e pavarur, më 17 shkurt 2008, nuk kishte kurrfarë federate, bile as kuazifederata Serbia dhe Mali i Zi nuk

ekzistonte më. Me atë shpërbërje në vitin 2006, pati marrë fund çdo element federalizmi. Rrjedhimisht pranimi i kontinuitetit të Serbisë në OKB nuk ka qenë legal, aq më pak me Kosovën brenda, meqë Kosova ka qenë edhe njësi e federalizmit të RSFJ-së. Në tërë këtë ngatërresë ka edhe një situatë absurde: referimi në rezolutën 1244 në shtetin e RFJ, (së cilës nuk i është pranuar kontinuiteti me RSFJ) nuk ka qenë i logjikshëm e as legal. Rezoluta 1244 është miratuar para se të pranohej RFJ në OKB! Pra, rezoluta i është referuar një entiteti shtetëror që nuk ka qenë anëtare e OKB-së, sepse siç u tha, RFJ është pranuar në OKB më 1 nëntor 2000! Prandaj rezultoni se edhe bombardimet e NATO-s janë bërë ndaj një shteti që nuk ka qenë fare anëtar i OKB-së e për atë arsye, as nuk

ka pasur nevojë të kërkohej leja e Këshillit të Sigurimit të OKB-së për bombardimet e NATO-s kundër caqeve ushake në RFJ (Serbia e Mali i Zi.) Prandaj pavarësia e Kosovës më 17 shkurt 2008 nuk ka të bëjë aspak me atë shtet (RFJ-Serbia e Mali i Zi) që nuk ka asnjë kontinuitet me RSFJ, ku Kosova ka qenë njësi e federalizmit jugosllav. Faktikisht as rezoluta 1244 nuk është në kolizion me shpalljen e pavarësisë, gjë që e ka konfirmuar edhe opinioni i Gjykatës së Drejtësisë. Pra, ngado që të shihet problemi, shihet se Llavrovi tenton të mashtrrojë. Pse? Sepse kufijtë për të cilët flet Llavrovi, i ka prishë RFJ përkatësisht Serbia e Mali i Zi, jo komuniteti ndërkombëtar. As Kosova. Kosova e ka shpall pavarësinë në kufijtë e vet, të njohur me Kushtetutën e RSFJ-të vitit 1974, ndërsa siç u

dëshmuar tashmë, RFJ (Serbia e Mali i Zi) nuk ka pasur kontinuitet legal më të. (Nuk jam i sigurt se i kanë kuptuar si duhet këto gjëra qeveritarët-negociatorët tanë që nga viti 2007 e deri sot. Po t'i kishin kuptuar, nuk do ta shndërronin dialogun në një "çështje të brendshme" të Serbisë, siç faktikisht e kanë shndërruar.) Kjo sa i përket aspektit legal. Ndërsa sa i përket aspektit moral, Sergej Llavrovi nuk ka fytyrë të flasë për ruajtjen e kufijve të shteteve, meqë Rusia e tij me ndërhyrje imperiale dhe me agresion ushtarak i ka shkelë kufijtë e shteteve sovraane dhe anëtare të OKB-së, si Gjeorgjia, Moldavia e sidomos Ukraina, ku në emër të kërkesës për ndryshimin kufijve, Rusia e Llavrovit është duke bërë urbidid, kulturocid dhe gjenocid.

Kurti takon ambasadorët e Quintit, diskutojnë për kërkesën e Serbisë për organizmin e zgjedhjeve në zonat serbe në Kosovë

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Kryeministri Albin Kurti, bashkë me zëvendëskryeministrin Besnik Bislimi, kanë pritur në takim përfaqësuesit diplomatikë të shteteve të Quintit dhe Bashkimit Evropian. Ata kanë diskutuar për temat aktuale si dhe kërkesën e Serbisë drejtuar OSBE-së për mbajtjen e zgjedhjeve në territorin e Republikës së Kosovës. Kryeministri Kurti theksoi se për këtë çështje e ka informuar tashmë OSBE-në se për organizim të votimeve jashtë Zyrës Ndërlidhëse të Serbisë në Prishtinë është e nevojshme një marrëveshje ndërshtetërore dhe

se kërkesa për një marrëveshje të tillë duhet të vijë nga Serbia si palë e interesuar. Ai shprehu keqardhjen për mungesën e gatishmërisë së Serbisë për një marrëveshje të tillë që do t'u mundësonte shtetasve të Republikës së Kosovës që kanë edhe shtetësinë e Serbisë të marrin pjesë në zgjedhje sipas praktikave më të mira evropiane ndërshtetërore për votim nga jashtë vendit. Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, tha të premten se zgjedhjet parlamentare të 17 dhjetorit nuk do të mbahen në zonat serbe në Kosovë sepse, siç u shpreh ai, "kryeministri i Kosovës, Albin



Kurti, nuk dëshiron t'i lejojë serbët të kenë të drejta elementare". "Perëndimi do të

thotë se nuk ka mundësi t'i bëjë presion Kurtit dhe do të lëshojë një deklaratë. Tashmë ka pasur

një deklaratë nga zëdhënësi i Bashkimit Evropian, Peter Stano, dhe kaq", ka pohuar Vuçiqi në Dubai, ku po merr pjesë në Samitin e liderëve për ndryshimet klimatike, raporton Beta. Ai tha se "Kurti insiston ekskluzivisht në njohjen e pavarësisë së Kosovës si kusht për mbajtjen e zgjedhjeve". "Ne duhet ta njohim Kosovën në mënyrë që serbët të marrin pjesë në zgjedhje. Pikë. Asgjë më shumë dhe asgjë më pak. Dhe, këtë e dinë të gjithë në Serbi dhe në Evropë. Është mirë që ata do të reagojnë për këtë, por ne nuk do të kemi asgjë nga ai reagim", ka theksuar Vuçiq.

KPK-ja zgjodhi drejtorin e Sekretariatit dhe drejtorin e Njësitit për Shqyrtimin e Përformancës së Prokurorisë

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga kryesuesi Jetish Maloku, mbajti takimin e 237 me radhë, në të cilën zgjodhi Sami Istrefin në pozitën e drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së (SKPK) dhe Arta Kelmendin në pozitën e drejtoreshës së Njësitit për Shqyrtimin e Përformancës së Prokurorisë (NjShPP). KPK-ja ka themeluar Panelin Hetimor për rastin e një prokurori në Prokurorinë Themelore në Prishtinë dhe ka aprovuar Plotësimin dhe Ndryshimin e Vendimit të KPK-së, të datës 13 tetor 2023, lidhur me tejkalinim



nga 1 për qind në kuotën 2.05 për qind për pagesa të kujdestarisë së prokurorëve. Gjithashtu, KPK-ja ka aprovuar rekomandimin e Komisionit për Vlerësimin e Përformancës së Prokurorëve për

zgjatjen e trajnimit fillestar për dy prokurorë, të cilat kanë qenë në pushim të lehonisë dhe ka aprovuar kërkesën e Komisionit për Administrimin e Prokurorive për themelimin e grupit punues të

përdoruesve për sistemin prokurorial në kuadër të projektit të Sistemit Menaxhues Informativ të Lëndëve (SMIL). Anëtarët e Këshillit miratuan Raportin e Komisionit për

Rishqyrtim për procesin e emërimit të kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë dhe trajtuan kundërshtimet përkatëse, me ç'rast aprovuan pjesërisht të njëjtat dhe miratuan rekomandimin e këtij komisioni që kjo çështje të kthehet te Paneli Vlerësues për rishikim. Po në këtë takim KPK-ja ka miratuar edhe Raportin për Vlerësimin e Performancës së njëmbëdhjetë prokurorëve me mandat të përhershëm, si dhe ka mbajtur një seancë dëgjimore disiplinore për rastin e një prokurori në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, kurse vendimi do të nxirret siç parashihet me ligj.

ASK-ja: Mbi 12 mijë të punësuar më shumë në tetor në krahasim me vitin paraprak

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Statistikat Administrative të Tregut të Punës për muajin tetor 2023. Sipas këtyre të dhënave, në muajin tetor 2023, të punësuar me pagë primare ishin 374 409 persona, ku krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak që kishte 361 822 të punësuar, ka rritje për 12 587 persona, ose 3,5 % të punësuar me pagë primare.

Grupmosha me më së shumti të punësuar me pagë primare ishte 25-34 vjeç. Në muajin tetor 2023 të punësuar me pagë sekondare ishin 18 242 persona krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (tetor 2022, që ishin 17 095). Pra ka rritje për 1 147 persona, ose shprehur në përqindje (6,7 %) të punësuar më shumë me pagë sekondare. Grupmosha me më së

shumti të punësuar me pagë sekondare ishte 35-44. Punësimi më i theksuar për muajin tetor ishte te këto aktivitetet: administratë publike dhe mbrojtje, sigurim i detyrueshëm social (23,1 %); tregti me shumicë dhe pakicë (21,3 %); dhe prodhim (11,2 %). Këto të dhëna bazohen në të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) dhe Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK).



Kurti viziton Gjilanin, tregon për projektet që janë në planifikim për vitin e ardhshëm



GJILAN, 1 DHJETOR - Kryeministri Albin Kurti ka vizituar të premtën komunën e Gjilanit. Ai është pritur nga kryetari i saj Alban Hyseni. Kurti ka thënë se kjo vizitë e tij ka për qëllim për ta parë punën që po bëhet dhe për të dëgjuar për planet për vitin e ardhshëm. "Prej takimit të fundit në tetor 2022, Gjilani sot e ka Qendrën e Re të Mjekësisë Familjare, Mireshi shumë shpejt do të bëhet me çerdhe të re, ndërkaq sot përruram parkun 'Banja' me 17 mijë m² dhe fillimin e punimeve për zgjerimin e rrugës 'Hamdi Kurteshi' me vlerë 2.4 milionë

euro. Për vitin tjetër katër janë projektet kryesore: Stadiumi i qytetit për të cilin janë ndarë rreth 15 milionë euro. Procedura e tenderimit fillon javën e ardhshme; Unaza rrugore që në total do të kushtojë rreth 26 milionë euro e që është buxhetuar për vitin 2024; Bulevardi i qytetit në vlerë prej 12 milionë eurosh me 20 mijë m², hapësirë publike, me infrastrukturë nëntokësore, me parking nëntokësor, gjithashtu i buxhetuar për vitin e ardhshëm; dhe Autostrada e Gjilanit në të cilën po vazhdon puna për sajimin e problemeve që janë

paraqitur së fundmi me rrëshqitjen e dheut e që kanë shkaktuar vonesa drejt finalizimit të saj deri në Bresalc, kurse për vazhdimin e saj deri në Dheun e Bardhë tashmë është ndarë buxheti dhe në fillim të vitit tjetër do të fillojnë procedurat e prokurimit", ka thënë Kurti.

Kryeministri ka thënë se kryetari Alban Hyseni ka vazhduar t'i paguajë borxhet e komunës nga e kaluara. "Për dy vjet në zyrë tashmë janë paguar rreth 10 milionë euro, e për vitin e ardhshëm kanë mbetur më pak se dy milionë", ka deklaruar Kurti.

Bordi i AKP-së aprovoi pranim-dorëzimin e ekonomive pyjore tek Agjencia Pyjore e Kosovës

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Me qëllim të ruajtjes së fondit të pyjeve në Kosovë, Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në takimin e rregullt që ka mbajtur, ka aprovuar dorëzimin e Ndërmarrjes Ekonomia Pyjore me mijëra hektarë tek Agjencia Pyjore e Kosovës në përputhje me Ligjin mbi Pyjet. Përveç kësaj, ky bord ka aprovuar planin e punës dhe të performancës së AKP-së për vitin 2024, duke theksuar që viti 2024 do të jetë vit i përmblylljes së AKP-së në përputhje me strategjinë e aprovuar tashmë. Në këtë takim, gjithashtu, u

shqyrtua edhe raporti mujor për Brezovicën, për të cilën bordi kishte aprovuar investime shtesë në riparimin e pajisjeve të cilat do të shërbejnë për një resort më të mirë skijimi dhe renovimin e "Hotel Molikës" me qëllim të përmirësimit të shërbimeve për vizitorët e shumtë që pritet të ketë gjatë sezonit të dimrit. Për më tepër, Bordi i AKP-së ka kërkuar nga menaxhmenti që të merren të gjitha masat e nevojshme për t'u mundësuar pushuesve një turizëm të përshtatshëm dimëror. Ndër të tjera, Bordi i AKP-së ka aprovuar propozimet e

menaxhmentit për ta lejuar komunën e Podujevës për rrënimin dhe largimin e gërmadhave nëpër ngastrat e ndryshme kadastrale, të cilat tashmë kanë marrë karakter për të mirën publike dhe do të shpronësohen nga komuna e Podujevës.

Gjithashtu, Bordi i AKP-së ka aprovuar edhe kërkesa të tjera nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga asetet të cilat tashmë shfrytëzohen për të mirën publike, por mbahen ende në regjistrat e Ndërmarrjeve Shoqërore të menaxhuara nga AKP-ja.



Falja e tatimit në pronë, Ibrahim: Komunat do të humbin mbi 28 milionë euro në vitin 2024

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Komunat e Kosovës rrezikojnë të futen në kolaps gjatë 2024 nëse zbatojnë faljen e tatimit në pronë në vlerë 100 euro. Llogaritjet që bëhen do të jetë mbi 28 milionë euro. Në këtë situatë ndikon edhe mendimi juridik i Gjykatës Supreme, ku mësimdhënësit duhet të kompensohen për licencimin e tyre si dhe normën e inflacionit. Kështu thotë drejtori ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), Sazan Ibrahim,

derisa potencon se zbritja e normës tatimore për tatimpaguesit nga 0.15 për qind e vlerës së pronës në 0.10 për qind nga disa komuna, do të ndikojë në zvogëlimin e buxhetit të tyre. "Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim që për faljen e tatimpaguesve për faturat deri në vlerën e 100 eurove, kompetent të jetë niveli lokal, përkatësisht kuvendet komunale. Në disa raste kuvendet komunale gjatë kësaj jave nuk e kanë përkrahur këtë

ide që të bëhet falja e vlerës së faturës deri në 100 euro, sepse ata i kanë përgatitur buxhetet komunale, të cilat kanë qenë të miratuara në shtator të këtij viti, për vitin e ardhshëm, dhe nëse bëhet një falje e tillë në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, dëmi të cilin Asociacioni i Komunave të Kosovës e ka llogaritur, bazuar në argumentet që na kanë ofruar komunat, do të jetë rreth 28 milionë euro", ka thënë Ibrahim.



Kush ishte Moisiu i vërtetë, më i madhi mes profetëve

Ai nuk i ngjan aspak protagonistit të filmit “Eksodi: Zotër dhe mbretër”, dalë disa vite më parë në kinema. Po kush ishte njeriu që i hapi ujërat e Detit të Kuq? Përveçse është profeti më i madh për popullin hebre, Moisiu nderohet si një shenjt në Krishtërim, dhe për myslimanët është një nga paraardhësit e Muhamedit.

Gjithçka që dimë për të vjen nga Testamenti i Vjetër. Sipas traditës më të lashtë hebreje, ai shkroi pesë librat e parë të Biblës, të quajtur Pentateuk ose Torah. Por më vonë, tek Pentateuk studiuesit vërejtën mospërputhje të shumta në gjuhë dhe anakronizma, të cilat e bëjnë të pamundur që ky libër t’i atribuohet vetëm një autori.

Ata kanë arritur në përfundimin se 5 librat janë shkruar nga disa njerëz, dhe në periudha të ndryshme kohore. Gjithsesi, Moisiu mbetet protagonist i padiskutueshëm i Torah: nga 5 librat, vetëm i pari (Zanafilla) nuk flet për udhëheqësin e Izraelit.

Sipas librit të Eksodit, që tregon historinë e Moisiut që nga lindja e tij, derisa Zoti i dha Tabelat e Ligjit, prindërit e tij ishin Johebi dhe Amrami, dy izraelitë të fisit të Levit, që ndodheshin në Egjipt me fëmijët, Aronin dhe Miriamin. Meqë ligjet e Faraonit, kërkonin vrasjen e të gjithë djemve hebrej, kur lindi Moisiu, e ëma e futi atë në një shportë dhe e la buzë lumit Nil. Të qarat e vogëlushit, u dëgjuan nga vajza e Faraonit, që pasi e zbuloi shportën dhe e qetësoi fëmijën, vendosi që ta adoptojë atë.

Me sugjerimin e të motrës, ajo zgjodhi që fëmija të ushqehet nga nëna e tij natyrale. Moisiu, u rrit nga e bija e Faraonit, duke e harruar për një farë kohe misionin për të cilin ishte përzgjedhur nga Zoti. Por kur u rrit, ai u ndërgjegjësua për vuajtjet që po pësonin hebrejtë në Egjipt, të cilët trajtoheshin si skllavër nga egjiptianët.

Madje një ditë ai vret një egjiptian, që po rrihte pa mëshirë një izraelit, dhe e fsheh në rërë trupin e tij. Por shumë shpejt nisën të qarkullojnë zëra mbi autorin e krimit, dhe pasi u



zbulua Moisiu u detyrua të arratiset në tokën shkretinore të Madianës (sot një rajon i Arabisë Saudite).

Atje ra në sy për ndjenjën e tij të lindur të drejtësisë, duke mbrojtur një grup vajzash nga abuzimet e disa barinjve të zonës. Në shenjë mirënjohje ndaj të huajit, babai i 7 vajzave të reja i ofroi për grua njëren prej tyre, Ziporën, me të cilën Moisiu pati 2 djem.

Ndërsa po kulloste kopenë me bagëti të vjehrit të tij, ai zbulon misionin që i kishte rezervuar Zoti. Në malin Oreb, Moisiu pa një shkurre që digjej por pa u konsumuar. Duke u afruar më pranë nga kurioziteti, ai dëgjoi atje për herë të parë zërin e Zotit. Ai e urdhëroi të rikthehej sa më parë në Egjipt, të ribashkohej me vëllanë e tij Aron, dhe të çlironte izraelitët nga skllavëria. Moisiu u nis për në Egjipt, dhe kur u takua me Faraonin, i paraqiti kërkesat e tij, të cilat u pritën me arrogancë dhe refuzim nga udhëheqësi i Egjiptit.

Për ta bindur që t’i lintë të lirë izraelitët, Zoti e godet popullin egjiptian me 10 fatkeqësi, njëra me e rëndë se tjetra: shndërrimin në gjak të ujërave të Nilit, pushtimin nga bretkosat, mushkonjat dhe mizat, ngordhjen e bagëtive, shfaqjen e ulcerave tek kafshët dhe njerëzit, stuhitë e breshërit, pushtimi nga

karkalecat, errësirë e plotë për disa ditë me radhë, dhe vdekja e të porsalindurve.

Toka e Premtuar

Një natë para largimit, që t’i jepte mundësi Engjëllit të Vdekjes të kuptonte se cilat shtëpi duhet të shmangte, duke shpëtuar kësaj jetë të pafajshme, dyert e shtëpive ku jetonin izraelitët, u lyen me gjakun e qengjave. Nga ai moment kremtohet Pesach, Pashka që çifutët e kujtojnë edhe sot e kësaj dite.

Të nesërmen Faraoni, i tmerruar nga vdekja e djalit të tij të porsalindur, e lejoi Moisiun dhe popullin e tij të largohet nga Egjipti. Por pak ditë më vonë, ai u pendua për vendimin që mori, dhe pasi vuri veten në krye të ushtrisë, u vu në ndjekje të izraelitëve.

Ai i arriti ata në brigjet e Detit të Kuq. Një shtyllë zjarri e dërguar nga Zoti, i bllokoi egjiptianët, ndërsa Moisiu, gjithnjë sipas urdhrat hyjnor, e drejtoi shkopin e tij drejt ujërave, të cilat ndahen dhe ngrihen në të djathtë dhe të majtë, duke lejuar kalimin e hebrejve në mes të detit.

Ato u mbyllën menjëherë kur në shtegun e hapur nisën të kalonin me shpejtësi karrocet me ushtarët egjiptianë, të cilët vdiqën që të gjithë të mbytur. Moisiu e çliroi popullin e Izraelit nga skllavëria,

por misioni i tij nuk përfundoi aty. Pasi mori nga Zoti Tabelat e Ligjit që përmbanin Dhjetë Urdhërimet në malin Sinai, ai u përball disa herë me rebelimet, pakënaqësitë dhe mosmirënjohjen e popullit të tij hebre.

Si ndëshkim nga Zoti, ai dhe populli i tij u detyruan të enden 40 vjet në shkretëtirë, midis sulmeve të përsëritura nga fiset armike, përpara se të mund të shkëlqin në Tokën e Premtuar.

Por vetë Moisiu nuk hyri në të: Dikur edhe ai dyshoi tek Zoti, dhe për këtë arsye iu ndalua hyrja. Sidoqoftë, nga lartësitë e malit Nebo, ai e pa nga distanca Tokën e Shenjtë, dhe në fund mundi që të vdesë i qetë.

Hollivudi nuk i qëndron përherë besnik historisë

Saktësia e filmave historikë, është shpesh e debatueshme, dhe filmi i ri i Ridley Skot “Exodi: Zotër and mbretër” nuk bën përjashtim. Kritikkat ndaj regjisorit anglez, kanë të bëjnë me përzgjedhjen e aktorëve kryesorë, Kristian Bejl në rolin e Moisiut dhe Xhoel Edgerton në atë të Faraonit Ramses II. Që të dy, pavarësisht nxirrjes dhe trukut të theksuar, e kanë lëkurën shumë të bardhë, në një kohë që personazhet e Moisiut dhe Ramsesit, përkatësisht izraelitë dhe

egjiptianë, duhet të kenë pasur ngjyrën tipike bojëkafë të banorëve të Lindjes së Mesme.

Si për të ndezur më tej polemikat, dhe ato që provokuan akuzat për racizëm, deri edhe kërcënimet për bojkotim të filmit, ishte fakti që aktorët që luajnë rolin e skllavërve janë zezakë, duke forcuar kështu sipas kritikëve stereotipin e “protagonistit të bardhë”, dhe “zezakut në plan të dytë”.

Regjisori Ridley Skot iu përgjigj kritikave, duke thënë se nëse nuk do të kishte zgjedhur për rolin kryesor aktorë të njohur, sikurse është Kristian Bejl (i famshëm për rolin e Batmanit), producentët nuk do ta kishin financuar filmin, ndaj ai nuk kishte luksin të zgjidhte aktorë nga Lindja e Mesme, që do të ishin të panjohur për audiencën botërore.

Por “Eksodi” nuk është filmi i parë që është kritikuar, për mungesë të skrupulozitetit në rindërtimin e historisë origjinale. “U-571”, filmi i Xhonathan Mostou i vitit 2000, merret me historinë e deshifrimit të Enigmës, pajisjes gjermane që kodonte mesazhet që shkëmbente ushtria gjermane gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ai ndryshoi kombësinë e protagonistëve, duke i bërë ata amerikanë, dhe jo britanikë, dhe duke ua rrëmbyer kësaj meritë këtyre të fundit.

“Braveheart”, është quajtur filmi më i keq historik i realizuar ndonjëherë: Biografia e heroit të Skocisë Uiliam Uollas, luajtur nga Mel Gibson në vitin 1995, është plot gabime përfshirë përdorimin e kilit, fundit tipik scocez, që në fakt nisi të përdorej disa shekuj më vonë.

Trillim ishte edhe një histori dashurie, ajo e protagonistit me princeshën Isabela, e cila në atë kohë ishte në fakt vetëm një vajzë e vogël.

Ndërkohë, është sërish Ridley Skot ai që akuzohet për pasaktësi të mëdha me filmin “Gladiator” të vitit 2000, me aktorët Rasëll Krou dhe Hoakin Feniks. Filmi nis me vrasjen e perandorit Mark Aurel nga djali i tij Komoto, i etur për t’u ngjitur në fron. Por në fakt Mark Aureli vdiq nga një sëmundje, dhe djali i tij Komoto e kishte zëvendësuar prej disa vjetësh. / Storia in Rete – Bota.al



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport



Sot përballen Liria - Gjilani dhe Llapi - Malisheva

Prishtinë, 1 dhjetor - Superliga e Kosovës në futboll rikthehet në aksion këtë fundjavë me ndeshjet e xhiros së 16. Kjo xhiro nis sot (e shtunë) me duelet Liria - Gjilani dhe Llapi - Malisheva, sfida këto tejet të rëndësishme dhe të cilat pritet të prodhojnë duele

interesante. Xhiroja e 16-të do të vazhdojë të dielën pasdite, ku do të luhen tri ndeshjet e fundit të kësaj fundjave. Sfida kryesore do të luhet në Klinë, ku ballafaqohen Dukagjini dhe Prishtina, derisa në dy duelet e tjera përballen Ballkani - Fushë Kosova dhe Drita - Feronikeli '74.

Superliga - Java e 16-të

Të shtunën takohen:
Liria - Gjilani
Llapi - Malisheva

Të dielën takohen:
Ballkani - Fushë-Kosova
Dukagjini - Prishtina
Drita - Feronikeli '74



Kosova promovohet në Ligën B të Ligës së Kombeve

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Përfaqësuesja e Kosovës në konkurrencën e femrave e ka siguruar kalimin në Ligën B të Ligës së Kombeve, pasi ka shënuar fitore në ndeshjen vendimtare ndaj Bullgarisë (5-1). "Futbollistet e Kosovës patën një tjetër paraqitje të shkëlqyeshme në kuadër të Grupit 5 në Ligën C, duke e mposhtur Bullgarinë në ndeshjen vendimtare për promovim në Ligën B, me rezultat 5:1, në sfidën e zhvilluar në stadiumin 'Zahir Pajaziti'. Përgëzoj futbollistet dhe stafin në krye me përzgjedhësen Anneli Andersen për këtë sukses dhe për

përkushtimin e madh gjatë ndeshjeve të kësaj gare. Kjo është një arritje e madhe e futbollit të femrave dhe dëshmon punën e mirë që është bërë vitet e fundit. Krenar me ju dardane! Forca Kosovë!", ka thënë Agim Ademi, kryetar i Federatës së Futbollit të Kosovës.

Ndeshja ishte në kuadër të grupit 5 në Ligën C të Ligës së Kombeve dhe u zhvillua në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë. "Dardanet" e kanë siguruar kalimin në Ligën B të kësaj gare për edicionin e ardhshëm. Që nga fillimi të përzgjedhurat e Anneli Andersenit kanë mbizotëruar në lojë, duke sulmuar në vazhdimësi portën bullgare, por ishin mysafiret që e zhblllokuan



rezultatit, e në minutën e 26 Dimitra Ivanova realizoi gol. Kosova u rikthye në lojë gjashtë minuta para se ekipet të shkoni

në pushim. Donjetë Halilaj shënoi golin e barazimit për rezultatit e pjesës së parë 1-1. Në pjesën e dytë Kosova realizoi gol nëpërmjet

Valentina Metajt në minutën e 58. Pas këtij goli, Kosova dominoi plotësisht dhe me aksione të rrjedhshme e bëri fitoren bindëse. Shifrat në 3-1 i çoi Modesta Uka në minutën e 71-të. As pas kësaj epërsie "dardanet" nuk u kënaqën dhe vazhduan të sulmojnë me intensitet drejt portës bullgare. Si rrjedhojë erdhi edhe goli i katërt në minutën e 84-t nga sulmuesja Erëleta Memeti. E njëjta futbolliste shënoi edhe golin e saj të dytë dhe të pestin për Kosovën, një minutë para se takimi të përmbyllej. Përtej rezultatit 5-1, Kosova pati paraqitje spektakolare në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë, duke dëshmuar se e meriton të jetë pjesë e Ligës B të Ligës së Kombeve.

Tre derbi në Superligën e basketbollit

"Epoka e re"

PEJË, 1 DHJETOR - Fundjava do të sjellë përballje interesante në elitën e basketbollit të Kosovës. Kjo xhiro do të hapet me sfidën në mes të Pejës dhe Golden Eagle Yllit apo kampionit dhe ish-kampionit apo edhe skuadrave verdhezi. Ky duel i gjen skuadrat në forma të ndryshme, pasi pejanët kanë pësuar tri humbje në tri ndeshjet e fundit, që erdhën pas shtatë fitoreve radhazi, kurse therandasit kanë pesë fitore radhazi, pasi që nuk e kishin



nisur aq mirë këtë edicion. Përballja e dytë e së shtunës zhvillohet në mes të Vëllaznimit dhe Trepçës, dy skuadra në formë të lartë. Kuqezinjët kanë gjashtë fitore radhazi pas katër humbjeve, ndërsa mitrovicasit janë në vendin e parë me tetë fitore e dy humbje. Sigal Prishtina dhe Istogu do të përballen të dielën. Bardhekaltrit kanë pasur rënie të formës në ndeshjet e fundit, duke bërë ndryshime edhe në shtabin teknik, ndërsa numërojnë pesë fitore e pesë humbje, ndërsa istogasi janë në vendin e fundit me një fitore dhe

nëntë humbje. Java e 11-të do të mbyllet me derbin prizrenas mes Proton Cable Prizrenit dhe Bashkimit. Proton Cable Prizreni ka tri fitore e shtatë humbje, kurse Bashkimi ka katër fitore dhe gjashtë humbje.

SUPERLIGA - Java e 11

Të shtunën takohen:
17:00 Peja-Golden Eagle Ylli
19:00 Vëllaznimi-Trepça

Të dielën takohen:
17:00 Sigal Prishtina-Istogu
19:00 Proton Cable Prizreni-Bashkimi

Trepça - Besa Famgas, derbi i javës në hendboll

Mitrovicë, 1 dhjetor - Fituesja e Kupës së Kosovës, Trepça, takohet me kampionen dhe fituesen e Superkupës, Besa Famgasin, në kryendeshjen e xhiros së 12-të të Superligës së Kosovës në hendboll. Ndeshja zhvillohet të shtunën prej orës 17:00 në palestrën "Minatori" në Mitrovicë.

Trepça e Besa Famgas janë përballur në tri finalët e këtij viti. Besa i ka fituar dy, ndërsa Trepça

një. Ndeshjen e parë të këtij edicioni, të luajtur në Pejë në kuadër të xhiros së pestë, e kishte fituar Besa me rezultat të ngushtë, 36:33. Pritet ndeshje e fortë dhe interesante në "Minatori".

Besa Famgas është e dyta me 18 pikë, ndërsa Trepça e treta me 16 pikë.

Të shtunën është edhe ndeshja Kastrioti - Deçani, që fillon në orën 19:00.

Të dielën janë ndeshjet Prishtina - Vëllaznimi (13:00) dhe Rahoveci - Vushtrria (18:00). Në Ligën e Parë të hendbollistëve është java e nëntë. Katër ndeshje janë të shtunës: Samadrexha - Vjosa (16:00), Istogu - Llapi (12:00), Prizreni - Dukagjini (19:30), Lepenci - Drita (20:00). Të dielën prej orës 16:00 në Shtime takohen Ulpiana dhe Drenica në ndeshjen e xhiros së fundit.



Ramadani: I dua në grup Italinë, Gjermaninë dhe Zvicrën

TI RANË, 1 DHJETOR - Lecce do ta presë Bolonjën të dielën në ndeshjen e vlefshme për javën e 14-t të Serisë A. Në prag të këtij dueli, mesfushori Ylber Ramadani ka dalë në konferencë për shtyp, ku nuk munguan as pyetjet për shortin që pritet të hidhet të shtunën

për Evropianin 2024. “Çdo ditë ne punojmë për të bërë më mirë. Të dielën ka një ndeshje të vështirë në të cilën duhet të marrim pikë. Ne jemi profesionistë dhe e dimë që nuk kemi fituar 8 ndeshje. Të dielën duhet të hyjmë me kokën e duhur për të fituar. Ne krijojmë

raste, por duhet ta mbyllim ndeshjen, duke filluar tashmë të dielën. Kundër Romës ne luajtëm një lojë të shkëlqyer dhe humbëm në dy minuta. Duhet të hyjmë të dielën për ta fituar ndeshjen, kjo do të na jepte besim”, ka thënë Ramadani. “Shorti i ‘Euro 2024’? Do të doja

një grup Itali-Gjermani-Zvicër-Shqipëri. Të shohim nesër. Është kualifikimi i dytë në historinë tonë, një mundësi e madhe. Kemi një ekip vërtetë fortë, 7-8 prej tyre luajnë në Serinë A. Është një ëndërr për mua. Që i vogël e kam dashur këtë”, ka deklaruar Ramadani.



Zidane tregon lojtarin më të mirë që ka luajtur, momenti kulminant dhe më i keq i karrierës si futbollist

PARIS, 1 DHJETOR - Zinedine Zidane ishte protagonist i madh i episodit të fundit të “The SKWEEK Show”, një podcast i drejtuar nga legjenda e basketbollit, Tony Parker. Në emision, Zidane kujtoi disa momente qesharake nga karriera e tij, si ai me Ronaldon, një nga yjet e pabesueshëm me të cilin luajti te Real Madridi “galacticos”: “U shkruva së qeshuri kur isha me Ronaldon, brazilianin, dhe ai më tha: Sot do t’ju hedh dy topa. Ai e tha dhe e bëri vërtetë”. Ndër të tjera, ish-numri 5 i bardhë nuk e ka problem të pranojë, në përgjigje të pyetjes së Parker, se ‘Ronnie’ është lojtari më i mirë me të cilin ka luajtur. Zidane këmbëngul në rëndësinë e rrethimit me njerëz të talentuar për t’u përmirësuar ditaditës, përveç brazilianit, të cilin e konsideron një person ‘fenomenal’ dhe që ‘bënte gjithmonë shaka’. Zidane, karriera: momentet më të mira dhe më të këqija: Mes Kupës së Botës dhe



Ligës së Kampionëve, ndoshta dy turnetë më të rëndësishëm për një futbollist, ish-lojtari i Juventusit zgjedh padyshim Botërorin e fituar në vendin e tij në vitin 1998 (duke shënuar dy gola në finale, ndaj Brazilit të Ronaldos): “Një arritje e pashoqe, ndjesia më e bukur që kam përjetuar”. Edhe pse kanë kaluar

më shumë se 25 vjet nga ai moment, Zidane e kujton si një nga triumfet e tij më të veçanta. Atë vit ai u rendit në “top 11”-shen e turneut dhe fitoi “Topin e Artë”. Edhe për momentin më të keq, francezi nuk ka dyshime: rënien me Cannes. Ai nuk luajti sepse ishte i ri, 20 vjeç, afër transferimit te Bordeaux.

Golden State fiton duelin me Clippersat, humbasin edhe Milwaukee dhe Lakersat



Chicago, 1 dhjetor - Minnesota vijon ta komandojë renditjen në Konferencën e Perëndimit pas fitores 101-90 ndaj Utah Jazzit. Sfidë e komanduar nga skuadra vendase, ku u dallua Townsi me 32 pikë e 11 rebounde. Pas kohës shtesë fiton Chicago, që mundi me rezultat 120-113 Milwaukeeen,

ndeshje ku dallimin e bëri Vuçevići, autor i 29 pikëve e 10 reboundeve. Lakersat u mundën me rezultat 133-110 nga Oklahoma, dy ekipe pretendente në Perëndim. Davis realizoi 31 pikë për Lakersat, por që s’mjaftuan, ndërsa 7 lojtarë të Oklahomas realizuan mbi 10 pikë

REZULTATET

Cleveland - Portland	95-103
Brooklyn - Charlotte	128-129
Miami - Indiana	142-132
New York - Detroit	118-112
Chicago - Milwaukee	120-113
Minnesota - Utah Jazz	101-90
Oklahoma - Lakers	133-110
San Antonio - Atlanta	135-137
Golden State - Clippers	120-114

(Shai 33 pikë). Pas kohës shtesë fitoi Atlanta, që mundi me rezultat 137-135 San Antonion, ku protagonist ishte Trae Yong, me 45 pikë e 14 asistime. Fitoi edhe ekipi i Golden States, që mundi me rezultat 120-114 Clippersat, sfidë e ekuilibruar. Curry me 26 pikë ishte shënuesi më i mirë për Warriorsin. Nuk zhgënjeu skuadra e Miamit, që falë 36 pikëve të Butlerit, mundi me rezultat 142-132 Indianan, ndërsa Portlandi triumfoi me rezultat 103-95 ndaj Clevelandit, ndeshje ku u dallua Shapre me 29 pikë.

SHKURT

Davies refuzon rinovimin me Bayernin, dëshiron kalimin në Real

Alphonso Daviesit i skadon kontrata në qershor të vitit 2025 dhe deri më tani ka refuzuar propozimet e klubit gjerman Bayern Munchen për rinovim kontrate. Davies, siç raportohet nga mediet gjermane dhe spanjolle, në fakt ka vendosur t’i japë fund aventurës së tij me “bavarezët” dhe t’u bashkohet “galaktikëve” të Real Madridit. Bayerni, edhe pse nuk ka hequr dorë nga ideja e rinovimit me anësin, tashmë ka nisur ta vlerësojë lamtumirën e këtij të fundit.

Mourinho: Lojtarët luajnë në mënyrë ‘sipërfaqësore’

Trajneri i Romës, Jose Mourinho, i akuzoi lojtarët për një “qasje sipërfaqësore” në barazimin 1-1 kundër Servetes në Ligën e Evropës. Romelu Lukaku ua dha avantazhin italianëve në pjesën e parë, por Chris Bedia barazoi pas pushimit në Gjenevë, duke e lënë Romën në vendin e dytë në grup, dy pikë prapa liderit Slavias së Pragës. “Duket se disa njerëz, që nuk kanë shumë përvojë evropiane, i luajnë këto ndeshje disi sipërfaqësisht. Unë me të vërtetë nuk e kuptoj. Kam luajtur 150 ndeshje në Ligën e Kampionëve që janë shumë më të rëndësishme se kjo dhe motivimi im për këto ndeshje është shumë i lartë. Janë gjithmonë të njëjtët djem që qëndrojnë të fokusuar për 90 minuta dhe nuk kam nevojë t’i përmend emrat e tyre. Pastaj ka lojtarë që kanë një qasje sipërfaqësore në këtë lloj loje”, ka thënë Mourinho. “Unë nuk do të bëj një dramë nga ky vend i dytë. Mendoj se është më shumë një dramë që disa njerëz humbën një mundësi duke luajtur me të njëjtin qëndrim që vazhdojmë të shohim. Ne kemi një skuadër fantastike, njerëz të mirë, njerëz profesionistë që e duan Romën dhe duan të bëjnë mirë. Kjo ka të bëjë më shumë me ADN-në, me zonën tuaj të rehatisë”, u shpreh trajneri portugez.

Hamiltoni komenton suksesin e Verstappenit: Fitoi pa derdhur djersë

Lewis Hamiltoni mbylli të dytin sezon me radhë pa regjistruar qoftë edhe një fitore në Formula 1. Megjithatë, sezoni i fundit tregoi një përmirësim të Mercedesit, me shpresën se në vitin e ardhshëm skuadra gjermane dhe britaniku do të rikthehen të konkurrojnë me Red Bullin dhe Max Verstappenin. Në një intervistë të fundit për BBC, Hamiltoni komentoi mbi suksesin dhe dominimin e holandezit në sezonin që u mbyll. 38-vjeçari theksoi se Verstappen ishte në një pozitë mjaft të favorshme falë makinës që funksiononte. Madje, sipas Hamiltonit, piloti i Red Bullit fitoi duke garuar i qetë dhe pa derdhur djersë. “Mjafton të shohësh pak kohët e vendosura në gara të ndryshme, aq mjafton për të kuptuar se Verstappenin garon i relaksuar në krye të çdo xhiroje. Mendoj se gjatë sezonit që lamë pas ai as nuk ka djersitur. Edhe në një rast që ishim pranë tij, s’erish besoj se nuk i kemi shkaktuar probleme. Ishte mjaftueshëm i shpejtë për ta menaxhuar atë situatë. Kur je në atë pozicion dhe me makinën që funksionon në perfeksion, atëherë edhe mund të relaksohesh. Në një situatë të tillë edhe gomat zgjasin më shumë, gjithçka ecën mbarë. Është shumë bukur të jesh në atë pozicion. Megjithatë, unë e pranoj se Red Bulli dhe Verstappenin kanë bërë një punë të shkëlqyer dhe se e meritojnë suksesin”, u shpreh Hamiltoni.

Nadali njofton rikthimin në fushë pas një viti

Rafael Nadal ka njoftuar në një video të publikuar në faqet e tij në rrjetet sociale se është gati të rikthehet në garat e tenisit. Kështu,

ish-numri 1 i botës deklaroi se do të garojë sërish në turneun e Brisbanes, i cili zhvillohet nga 31 dhjetori deri më 7 janar. “Përshëndetje të gjithëve!

Pas një viti jashtë, ka ardhur koha të rikthehem. Do të jetë në Brisbane në javën e parë të janarit. Shihemi atje. Besoj se kam punuar

mjaftueshëm në karrierën time sportive për të mos e mbyllur karrierën në një konferencë shtypi. Do të përpiqem ta përfundoj

karrierën time profesionale në mënyrën e duhur”, ka thënë Nadal kohë më parë, duke shfaqur tashmë imazhet e tij në palestër.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë-Ministraskoo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom/ Agency for Administration of Sequestered and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik

Datë 01.12.2023

Referenca: AAPSK – 012/2023

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/co pë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	Golf II, viti i prodhimit 1990, dizel, ngjyre hiri metalike-për skrap.	1 copë/për skrap	252.00€		
2	Mercedes-Benz 190D 201, viti i prodhimit 1987, dizel, ngjyre e zezë metalike-për skrap	1 copë/për skrap	224.00€		
3	Audi 89-80, viti i prodhimit 1990, dizel, ngjyre hiri metalike- për skrap	1 copë/për skrap	276.00€		
4	BMW 525, viti i prodhimit 1994, benzin, ngjyre e gjelbër, me targa vendore	1 copë	550.00€		
5	Renault Clio, viti i prodhimit 1994, dizel, ngjyre e kuqe, me targa vendore	1 copë	300.00€		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohen më së largu deri më 07.12.2023 në ora 11:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahtiri (ish Kazerma e FSK-se) fshati Llukar KK Prishtinë.

Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 07.12.2023, prej orës 10:00-11:00 në **Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë.**

Pasurit e sekuestruar ose te konfiskuara ne këtë procedure shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmartjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se ,në: <https://aaprk.rks-gov.net/> ose ne web faqen e MD-së <https://md.rks-gov.net> në linkun e AAPSK-së <https://aaprk.rks-gov.net/> Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Sektori i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00 Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 67 254



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Taulant Perolli nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Osman Zeka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Mimoza Bibaj komuna e Malishevës, shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Skyfer Haxhija nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Vjollca Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl.I sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë drejtimi Juridik.

- Arbnor Dervishaj shpall të pavlefshme dëftesat Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Naim Hasani shpall të pavlefshme diplomën Q.K."11 Marsi" Prizren.

- Lavdim Ibrahimimi shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cilë gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cilë gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

